



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 943/01-5038 dt. 29. 01 2024



Bazuar në nenin 11,12, dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe kërkesës për ndarje nr.09-943/01-4072 të dt.23.01.2024, që Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.01.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e parcelës kadastrale 202-0 Shtrubullovë

Neni 1

Me këtë vendim, kërkohet miratimi i ndarjes së parcelës kadastrale në Shtrubullovë, me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e ndërtimit të paralelës së shkollës SHFMU ‘Rasim Kiqina’.

Neni 2

Parcela që kërkohet të ndahet, është si më poshtë:

- Parcela kadastrale Nr.202-0 me sip.42964 m² zona kadastrale Shtrubullovë, propozohet që të bëhet ndarja e kësaj parcele kadastrale, ku prej sipërfaqes së përgjithshme të ndahet sipërfaqja S=18500 m².

Neni 3

Qëllimi i ndarjes së parcelës kadastrale 202-0 në zk. Shtrubullovë , bëhet për t'i hapur rrugë ndërtimit të paralelës së shkollës SHFMU “Rasim Kiqina”.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari


ARSYETIM

Me qëllim të realizimit të investimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për ndërtimin e paralelës së shkollës SHFMU 'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë, kërkohet që të bëhet ndarja e parcelës kadastrale 202-0 si më poshtë:

Për të realizuar ndërtimin e paralelës së shkollës SHFMU 'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë, nevojitet një sipërfaqje prej 18500 m², prandaj edhe do të bëhet ndarja e parcelës 202-0, ku nga sipërfaqje e përgjithshme e kësaj parcele do të ndahet sipërfaqja prej 18500 m².

Baskangjtur i gjeni:

- Certifikaten mbi të drejtat e pronësisë
- Kopjen e planit dhe
- Skicen e propozuar për ndarje.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI	
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor	Nr. V/L-29/24 Datë: 13.02.2024
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendimi 02 Nr. 943/01-5038 për ndarjen e parcelës kadastrale 202-0 në Shtrubullojë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 29.01.2024	

I nderuar kryetar Lladrovci,
I nderuar kryesues Hajdari,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me datë 01.02.2024 ka pranuar nga MAPL Vendimin 02 Nr. 943/01-5038 për ndarjen e parcelës kadastrale 202-0 në Shtrubullojë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 29.01.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

KONFIRMON

Vendimin 02 Nr. 943/01-5038 për ndarjen e parcelës kadastrale 202-0 në Shtrubullovë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 29.01.2024.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Vendimi i lartshënuar është i bazuar në Udhëzimin Administrativ Mmph - Nr. 12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës dhe në Kornizën e Punës për Matje. Andaj, mund të vazhdohet me procedurën për ndarjen e parcelës, pasi e njëjta është në pronësi të komunës.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Glllogocit dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

